



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 2/8 Prot

Vlorë, më 21 . 02 . 2024.

VENDIM
Nr. 01 , datë 15.02.2024
PËR

SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE MIRATIMIN E RINOVIMIT
TË LEJES NR. 7, DATË 11.06.2009 HEC "PICARI 1" TË SHOQËRISË
"PESHKU-PICAR 1" SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Saktësimin e koordinatave sipas raportit të monitorimit të ZABU-Vjosë datë 30.04.2021, të lejes me Nr.7, datë 11.06.2009, miratuar me vendimin Nr.7, date 11.06.2009 nga KBU Vjosë, si më poshtë:

HEC "PICARI 1"

a) Koordinatat e Veprës së Marrjes nr.1, do të saktësohen si më poshtë:

Nga:

- X= 4448503; Y= 4191890; Z= 288.3 m.m.n.d. (Gauss Kruger)

Në :

- X= 4419155; Y= 4448558; Z= 289 m.m.n.d. (Gauss Kruger)

- X= 504211.2; Y= 4447995.7; Z= 289 m.m.n.d. (KRGJSH)

2. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik me Nr.7, datë 11.06.2009, miratuar nga KBU Vjosë me Vendimin Nr.7, datë 11.06.2009 HEC "PICARI 1" me koordinatat e saktësuara, të shoqërisë "Peshku-Picar 1" sh.p.k, me vendndodhje: Në përroin

Gurra e Picarit, Njësia Administrative Picar, Bashkia Gjirokastrë, Qarku Gjirokastrë, sipas koordinatave si më poshtë:

3. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujqor: Në përroin Gurra e Picarit, Njësia Administrative Picar, Bashkia Gjirokastrë, Qarku Gjirokastrë.

HEC "PICARI 1"

Vepra e marrjes

- X= 504211.2
- Y= 4447995.7
- Z= 289 m.m.n.d
- Q mes=1 m³/s
- Q eko =0.23 m³/s
- Q llog=1 m³/s

Godina e Centralit

- X= 504573.6
- Y= 4447514.8
- Z= 270 m.m.n.d

Fuqia e instaluar N=200 kwh.

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike E= 1 200 000 kwh/vit.

4. Periudha e përdorimit të ujit do të jetë gjatë gjithë vitit, përjashtoj periudhën nga 1 Maj deri në 31 Gusht të çdo viti, ku prurjeve të mësipërme të ujit, do t'u zbriten sasia e ujit që do të përdoret për ujtitjen e kulturave bujqësore - 0.2 m³/sek.

5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

**KRYETARI I KBV VJOSË
FLAMUR MAMAJ**

